

# **Editorial 2014**

#### Diversiteti stilistik i kohës së sotme

Periudha e kohës së sotme, si asnjë periudhë historike më parë, sjellë një fenomen të ri – koekzistimin intenziv, të pa penguar, të rrymave dhe orientimeve të ndryshme stilistike. Këtë diversitet, si karakteristikë të kohës, ReMusica tashmë e ka pranuar dhe ngërthyer në fizionominë programore të saj.

Motoja e re e REMUSICA-s, e promovuar në vitet e fundit, mbështetet në principin e rifreskimit apo të regjenerimit të asaj të mëparshmes. Koha tregon se edhe rrymat më të suksesshme dhe më novatore të muzikës së Shekullit XX, në thelb janë reflektim indirekt i muzikës së dikurshme, me çka vetëm sa dëshmohet vazhdueshmëria e jetës. Indi i jetës është i pashkëputshëm.

Në edicioni e sivjemë, ballafaqimet stilistike janë edhe më të theksuara. Në të njejtën mbrëmje këmi Variacionet madhështore Goldberg të gjeniut barokien, J.S. Bahut dhe veprat karakteristike minimaliste të viteve të fundit (Koncerti i pizanistit holandez M. Worms). Në një mbrëmje tjetër kemi ballafaqimin e literaturës së re për tubë me Romantizmin muzikor, ciklin tërheqës "Stinët" të P.I.Çajkovskit, nën interpretim e pianistës më të spikatur sot në Shqipëri, Merita Rexha-Tërshana.

Përsëri në skenën e ReMusica-s kthehet miku ynë i vjetër Petrit Çeku, pas një mori suksesesh ndërkombëtare, që e bëjnë atë njërin prej dy-tre artistëve më depërtues kosovar në skenën botërore. Poashtu, sivjet prezantohen për herë të pare, disa nga artistët më cilësor të paraqitur në skenën muzikore kosovare në vitet e fundit. Ata janë: tubisti virtuoz Thomas Leleu, i zgjedhur si virtuoz i vitit 2012 në Francë, në Francë, në French Grammy Awards; dhe Ansambli me renome botërore i perkusioneve 'Krumata', nga Suedia

paraqitur në skenën muzikore kosovare në vitet e fundit. Ata janë: tubisti virtuoz Thomas Leleu, i zgjedhur si virtuoz i vitit 2012 në Francë, në French Grammy Awards; dhe Ansambli me renome botërore i perkusioneve 'Krumata', nga Suedia. Përherë të parë në Festivalin ReMusica do të paraqitet një Trio polake me një program të amplitudës së gjërë stilistike, që nga Chopin e deri te vepra premiale e kompozitorit të ri kosovar Ardian Halimi. Në Koncertin e Korit të Filharmonisë së Kosovës, do të shenohet 105 vjetori i lindjes së kompozitorit Lorenc Antoni, e poashtu edhe 65 vjetori i lindjes së Dirigjentit të këtij Kori, Rafet Rudit me premierën e veprës së tij më të re vokalo-instrumentale 'Kurorë glëmbash' kvepra e pestë nga Cikli Afresk arbëresh). Koncerti tematik pedagogjik, sivjet i kushtohet instrumentit të kitarës. Janë porositur nga kompozitorët shqiptarë një numër miniaturash për kitarë, të bazuara në muzikën popullore shqipe. Vecanti tjetër e edicionit të sivjemë, gjithsesi është koncerti "Pasdite korale", ku do të marrin pjesë gjashtë ansamble korale të të rinjve të Kosovës. Veçori e edicionit të sivjemë është githsesi numri prej 300 pjesëmarësve në 13 koncerte, me artist të shkëlqyer vendor dhe ndërkombëtar, ansamble dhe kore. Për më shumë, Tribuna Muzikologjike këtë vit do të shtjellon temën intersante të Artit Psaltik të shekullit XIII-XIV nga referuesja Meri Kumbe.

#### Today's stylistic diversity

Today's era, as no other historical period, brings a new phenomenon – intensive, snag-less, coexistence of various stylistic streams and orientations. This diversity, as the characteristic of this era, has been accepted by ReMusica and embedded it in its programme physio-

ReMusica's new motto, promoted in the recent years, relies on the principle of updating or regenerating of what has happened in the past. Time voices that even the most successful and innovative music streams of the XX century, essentially represent indirect reflection of the past music, thus testifying the continuity of life. The matter of life is inseparable.

In this year's edition, stylistic clashes are clearly emphasized. In one evening we present magnificent Goldberg Variations, composed by Baroque genius J. S. Bach, and pieces of minimalist character of the recent years (the concert of the Dutch planist M. Worms). Another evening, we have the clash between the recent tuba literature and Romantic era, the appealing cycle "The Seasons" by R. I. Chaikovsky, interpreted by today's most prominent Albanian pianist, Merita Rexha-Tërshana. Our old friend Petrit Çeku has returned again to the stage of ReMusica, after a number international achievements that make him one of the few Kosovar breakthrough artists. Also, this year we present for the first time, some of the most qualitative artists presented on the Kosovar music stage in the recent years. They are: Thomas Leleu, a virtuoso tuba player, acclaimed as the virtuoso of the year in France in 2012, at the French Grammy awards; and World known percussion ensemble 'Kroumata' from Sweden.

For the first time at ReMusica Festival, a Polish trio will perform a program of a wide range styles, starting from Chapin, to the premier piece of a young Kosovar composer, Adrian Halimi. The concert of Kosovo Philharmonic Chair, will mark the 105th birthday of the composer Lorenc Antoni, and the 65th birthday of the Choir's conductor Rafet Rudi, with the premiere of his most recent vocal-instrumental piece 'Kuroè gleimbash'' (a fifth piece of Arbresh' Cikli Afresh').

This year's Pedagogical concert is dedicated to guitar. A number of miniatures have been commissioned from Albanian composers, whose theme is based on the traditional Albanian music. Another particularity of th

























# Program 2014



•	18 Maj / May E Diel / Sunday	20:00	HAPJA / OPENING • Katedralja «Nënë Tereza» / Cathedral "Mother Teresa"  ORKESTRA SIMFONIKE E FILHARMONISË SË KOSOVËS  KOSOVO SYMPHONIC ORCHESTRA OF KOSOVO PHILHARMONY
			Petrit ÇEKU kitarë / guitar LE FI-FI dirigjent / conductor
•	19 Maj / May E Hëne / Monday	20:00	KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS / KOSOVO PHILHARMONY CHOIR Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony"
			Rafet RUDI dirigjent / conductor
•	<mark>20</mark> Maj / May E Martë / Tuesday	12:30	Tribunë Muzikologjike "Arti psaltik në Shqipëri, nga shek. XIII deri në shek. XIV" Referues: Meri KUMBE, Shqipëri / Albania 。 Art Qender / <i>Art Center</i>
		20:00	NATA POLAKE / POLISH NIGHT • Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony"
			TRIO Staśkiewicz / Koziak / Tchorzewski
•	22 Maj / <i>May</i>	20:00	NATA FRANCEZE / FRENCH NIGHT • Salla e Kuqe / Red Hall
	E Enjte / Thursday		Thomas LELEU tubë/tuba
		20:45	JEHONË ROMANTIZMI / ROMANCE ECHO ● Salla e Kuqe / Red Hall
		20115	Merita REXHA TËRSHANA piano
	22		DAGDITE KODALE (GLOOM ATTOMORY S.H. M. A. A. M. M.
	23 Maj / <i>May</i> E Premte / <i>Friday</i>	16:00	PASDITE KORALE / CHORAL AFTERNOON • Salla e Kuqe / Red Hall
	2.1.6	20:00	NATA SUEDEZE / SWEDISH NIGHT • Salla e Kuqe / Red Hall
			KROUMATA ANSAMBËL PERKUSIONESH / PERCUSSIONS ENSEMBLE
•	24 Maj / May E Shtunë / Saturday	16:00	PARALELE STILISTIKE / STYLISTIC PARALLEL • Shkolla e Mesme e Muzikës "Prenk Jakova" Gjakovë Marcel WORMS piano
•	25 Maj / May E Diel / Sunday	20:00	RECITAL KITARË / GUITAR • Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony" Petrit ÇEKU guitar/kitarë
•	26 Maj / <i>May</i>	20:00	NATA MINIMALISTE / MINIMALIST NIGHT • Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony"
	E Hënë / Monday		Branka PARLIC piano
•	<mark>27</mark> Maj / <i>May</i> E Martë / <i>Tuesday</i>	20:00	NATA AKUSMATIKE BELGE / BELGIAN ACOUSMATIC NIGHT  Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony"
			Rafael MUNOZ-GOMEZ / Donika RUDI
•	28 Maj / <i>May</i>	12:30	KONCERTI PEDAGOGJIK / PEDAGOGIC CONCERT • Salla e Filharmonisë se Kosovës / Philharmony Hall
	E Mërkure / Wednesday		Miniatura për kitarë të bazuara në këngë popullore Miniatures for guitar based on Albanian folk songs
		20:00	PODIUM I HAPUR / OPEN PODIUM • Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony",







#### Orkestra e Filharmonisë së Kosovës

u themelua pas luftës së fundit në Kosovë në vitin 2000, me iniciativë të disa muziktarëve të dalluar kosovar. Fillimisht u paraqit si ansambël harkor e më vonë si orkestër kamertale, por Filharmonia e Kosovës pa dyshim paraqet vazhdimësinë e punës së ish Orkestrës Simfonike te Radio-Televizionit të Prishtinës, veprimtaria e së cilës u shua me dhunë nga regjimi serb ne vitin 1990. Pas konsolidimit të institucioneve shtetërore, Filharmonia e financon projektet koncertale dhe aktivitetin e rregullt të këtij institucioni të rendësishem muzikor. Në programet e Orkestrës u prezantuan veprat e një mori kompozitorësh botëror dhe atyre shqiptarë të të gjitha orientimeve stilistike.

#### Le FI FI

Le Fi Fi u lind në Hanoi, Vietnam. U diplomua në piano dhe dirigjim orkestral në Konservatorin e Hanoi-t dhe nga viti 1986 Le Fi Fi vazhdoi studimet në Konservatorin e Moskës 'P.I.Tchaikovsky' në klasën e dirigjentit të famshëm rus Leonid Nikolaev. Nga viti 1993, pas diplomimit, Le Fi Fi u emërua asistent - dirigjent dhe pas disa vjetësh dirigjent permanent i Filharmonisë së Magedonisë, kjo deri më 2000. Le Fi Fi është angazhuar si dirigjent mysafir i Orkestrës Simfonike të Radio Televizionit Serb në vitet 2000 - 2002. Ai gjithashtu është ftuar si dirigjent mysafir i Studios Operistike në Konservatorin e Moskës (Rusi), Teatrin e Operës dhe Baletit në Tiranë (Shqipëri), Orkestrën Simfonike në Vidin (Bullgari), Orkestrën Simfonike të Nishit (Serbi), Filharmoninë e Kosovës, Orkestrën Simfonike Kombëtare të Vietnam-it, Orkestrën Kamertale të Konservatorit të Hanoi-t, Operën dhe Baletin Vietnamez, Opera dhe Baleti Magedonas, Kori dhe Orkestra Kamertale e Radio-Televizionit Magedonas etj. Nga viti 2000, Le Fi Fi gjithashtu drejtoi Korin e Operës Maqedonase dhe punoi në realizimin e shumë operave të njohura. Le Fi Fi ka dirigjuar edhe me shumë kore, ansamble kamertale dhe është angazhuar në shumë turne si dirigjent mysafir në Rusi, Serbi, Mal të Zi, Bullgari, Shqipëri, Gregi, Gjermani, Francë, Itali, Suedi dhe Vietnam. Repertori i tij i gjerë përfshinë vepra që nga epoka e barokut deri tek ajo bashkëkohore. Si dirigjent Le Fi Fi ka bashkëpunuar me artist të njohur botëror si: E.Grac, M.Jashvili, N.Gutman, A.Shtarman, K.Jankovic, S.Krstic, K.Kener, E.Tabakov, A.Krastev, P.Despali, A.Egger, C.Anbacher, Dang Thai Son – si dhe ansamble të njohura si: Arabesque (Bullgari), Beltango (Serbi), Synthesis (Maqedoni) etj. Në vitin 2005 Le Fi Fi u nderua me thirrien 'Nderi i Kombit Vietnamez'i cili iu ndahet personaliteteve vietnameze gë kontribut të veçantë në zhvillimin e vendit. Nga viti 2007 Le Fi Fi ftohet si dirigjent kryesor i orkestrës Simfonike të Nishit.

**Petrit CEKU** (Shih programin - Recital Petrit Ceku)

# 19 Maj / May E Hënë / Monday

20:00 • Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony"

# KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS / KOSOVO PHILHARMONY CHOIR

Rafet RUDI dirigjent / conductor

**Lorenc Antoni** (105 vjetori i lindjes)

Hajde dalim kah pazari Shkojti çika Në shendin ulqinak

Vinçenc Gjini

Blegron delja

**Francis Poulenc** 

O Magnum Mysterium

Hajrullah Syla dirigjent / conductor

**Edvard Grieg - Kushtrim Gashi** 

Lux Aeterna (nga Suita 'Peer Gynt')

Hajrullah Syla dirigjent / conductor

**Rafet Rudi** 

Kurorë glëmbash /Afresk Arbëresh V/ për sopran, flaut, piano dhe kor

> Besa Lugiqi soprano Enkeleida Zajmi-Gorani flaut/flute Lejla Pula piano

**Ēriks Ešenvalds** 

O Salutaris Hostia

Adelina Paloja soprano Kaltrina Miftari soprano

**Ēriks Ešenvalds** 

Long Road

**Ko Matsushita** 

Karimatanu Kuicha





#### Kori i Filharmonisë së Kosovës

Kori i Filharmonisë së Kosovës është ansambël profesional (me 50 antarë profesionist) i cili vazhdon punën e Korit profesional të ish Radio-televizionittë Prishtinës, kor i cili veproi me shumë sukses që nga viti 1980 pikërisht nën drejtimin e dirigjentit aktual të Korit - Rafet Rudit. Me aktivitetin e tij Kori i Filharmonisë gjithashtu vazhdon të kultivojë traditën e këndiit koral që në Kosovë ekziston që nga viti 1945. Programi i këtij ansamble përfshin vepra të një game të gjërë stilistike, duke filluar nga veprat e mjeshtërve të vjetër (Montrverdi, Morley, Arcadelt, Marenzio) e deri te veprat e kompozitorëve të rëndësishëmtë literaturës nga literatura moderne korale (B. Britten, A, Pärt, G. Ligeti, E. Witacre etj.). Vend të rëndësishëm ne programet e Korit zë krjimtaria e kompozitorëve kosovarë/ shqiptarë. Kori, deri më tash ka pasur një sërë prezentime të rëndësishme në vend dhe jashtë Kosovës me programe a capella - Pula, Porec (Kroaci), Shkup, Tiranë, Durrës eti. Në bashkëpunim me Orkstrën simfonike të Filharmonisë, realizon vepra të mëdha vokalo- nstrumentale. Bashkë me Orkestrën simfonike të Filharmonisë së Kosovës me koncertet e tyre (shpeshherë në koncerte të parbashkëta në realizimi e veprave të mëdha), paraget bërthamën e rëndësishme të jetës muzikore në Kosovë.

#### Rafet RUDI

U lind në Mitrovicë, më 1949. Studimet i kreu pranë Akademisë së Muzikës në Beograd, ku diplomoi në degën e Dirigjimit dhe atë të Kompozimit. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Sarajevë, kurse specializoi për një vit shkollor në Konservatorin Nacional të Parisit, në klasën e kompozitorit Claude Ballif më 1979/80. Në perjudhën 1980 -1987 ishte dirigjent permanent i Korit profesional të Radiotelevizionit të Prishtinës. Merret me publicistikë dhe ka mbi 300 shkrime të ndryshme (eseistikë, recensione, kritikë etj.). Të botuar ka disa libra shkollorë, si dhe librin teorik "Sprova estetike." Është udhëheqës i Qendrës Kosovare për Muzikën e Re dhe Drejtor i Festivalit ndërkombëtar të Prishtinës -ReMusica. Aktualisht është Profesor në Akademinë e Muzikës në Prishtinë, ku ligjëron lëndën e Formave të muzikës dhe Kompozimin. Rudi është laureat i shumë shpërblimeve dhe mirënjohjeve: Çmimi i Dhjetorit të Kosovës për krijimtari; Çmimi i Festivalit Ndërkombëtar BEMUS; Çmimi vjetor i SHKK për vitin 1982 etj.

Në vijim janë prezantuar disa nga veprat kryesore: Simfonia, Koncert për kitarë dhe orkestër harkor, Kohë koncertante për piano dhe orkestër simfonik, Kuartet harkor, The return për mexosoprano dhe orkestër simfonik, Afresk arbëresh III për sopran, kor, 2 piano, organo, recitator dhe shirit manjetik, Icare ubi es për mexosoprano, kor, 3 timpani, gong, tr-ql, 2 piano, etj.

Veprat i janë ekzekutuar në Francë, Zvicër, Mbretërinë e Bashkuar, Itali, SHBA, Japoni, Holandë, Rusi, Shqipëri, Rumani, Spanjë, Suedi, Bullgari, Kroaci, Slloveni etj. Që nga viti 2014 Rudi është anëtar i Akademisë Europiane te Shkencave dhe Arteve.



E Martë / Tuesday

12:30 • Art Qender / Art Center

Tribunë Muzikologjike "Arti psaltik në Shqipëri, nga shek. XIII deri në shek. XIV" Referues: Meri KUMBE, Shqipëri / Albania

20:00 · Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony"

# NATA POLAKE / POLISH NIGHT

Anna Maria STASKIEWICZ violinë / violin Bartosz KOZIAK cello Jakub TCHORZEWSKI piano

# **Fryderyk Chopin**

Trio in g - minor, op.8 për violinë, cello dhe piano / for violin, violoncello and piano

# Karol Szymanowski

Pieśń Roksany për violinë dhe piano / duo violin and piano

## Ardian Halimi

Piano Trio për violinë, cello dhe piano / for violin, violoncello and piano

# Andrzej Panufnik

Trio









është projekt i prezantuar nga tre artist të shkëlqyer nga Polonia: Anna Maria Staśkiewicz (violin), Bartosz Koziak (çello) dhe Jakub Tchorzewski (piano).

#### Anna Maria Staśkiewicz

është laurate nga Gara e radios polake në Poznan (2006). Ajo ka performuar si soliste në Poloni ashtu edhe jashtë saj, si: në Shqipëri, Brazil, Kinë, Estoni, Gjeorgji, Gjermani, Itali, Japoni, Rusi, Zvicërr, Suedi, Turqi dhe SHBA. Pas një sërë koncertesh ne SHBA, me kitaristin Krzystof Meisinger, ajo është në pregaditje të botimi të CD-së me vepra nga Piazzolla, gjatë këtij viti.

## **Bartosz Koziak**

është fitues i Konkursit Ndërkombëtare të çellos Witold Lutoslawski, në Varshavë të Polonisë, në vitin 2001; fitues i çmimit të dytë në Konkursin Ndërkombëtar të çellos (Isang Yun in memoriam) në Tongyeong (Korea), në vitin 2006; fitues i çmimit të dytë në Konkursin Mikola Lysenko në Kiev, në vitin 2007. Si solist Bartosz Koziak, bashkëpunoi me Orkestrën Nacionale të Filharmonisë Polake, Sinfonia Varsovia, Orkestrën Filharmonike të Monte Karlos, Mynihut, Pragës, të dirigjuara nga Krzystof Penderecki, Antoni Wit, Jacek Kaspszyk, Tan Dun dhe Massimiliano Caldi. Së bashku me Ana Maria Staśkiewicz është në planifikim e sipër të inçizimit të një albumi duo, me vepra nga Martinů, Kodály, Ravel dhe Lutosławski.

#### Jakub Tchorzewski

ka performuar në Evropë dhe SHBA, ashtu si dhe në Japoni dhe Brazil, ndërsa disa nga paraqitjet e kaluara të tij janë inçizuar dhe transmetuar në radio kombëtare çeke, sllovake, zvicërrane dhe polake. Ai është pianisti i parë që ka inçizuar të gjitha veprat për piano solo nga Sándor Veress, kompozitor ky hungaro-zvicërran. Tchorzewski është kryesisht aktiv në Itali, ku edhe jeton, por gjithashtu është pjesë e turneve në Europë dhe USA.



# **22** Maj / May E Enjte / Thursday

20:00 • Salla e Kuge / Red Hall

# **NATA FRANCEZE** / FRENCH NIGHT

Thomas LELEU tubë / tuba Merita Rexha TËRSHANA piano

**Georg Friedrich Haendel** 

Concerto No. 1 in G flat I. II. et IV

**Camille SaInt-Saëns** 

Samson et Dalila de : "Mon coeur s'ouvre à ta voix" "Bacchanale"

**Edward Elgar** 

Salut d'amour

**Georges Bizet** 

Carmen de « Danse Bohème »

**Jean-Baptiste Arban** 

Le carnaval de Venise

**Ástor Piazzolla** 

Oblivion

Jean-Philippe Vanbeselaere

L'invité de Marc Somewhere over the rainbow

**Thomas LeLeu** 

Latin Project

**Vittorio Montl** 

Czardas







## Merita REXHA TËRSHANA

Është lindur në Tiranë, ku ka filluar studimet për piano që në moshë të voqël.

Ka studjuar në Liceun Artistik me mësuesen N. Porodini dhe studimet e larta në klasën e prof. M. Kristidhi, në Akademinë e Arteve në Tiranë. Më pas ka ndjekur disa kurse pasuniversitare në Gjermani me profesorë të njohur si Paul Badura-Skoda, Till Engel, etj.

Ka luajtur si soliste me orkestrat e RTSh, Teatrit të Operas e Baletit, Filarmoninë e Tiranës, orkestrën e Akademisë së Arteve, me dirigjentë të njohur shqiptar dhe të huaj. Ka marrë pjesë e ftuar në festivale prestigjoze si soliste dhe në asamble të muzikës së dhomës, si në Schleswig Holstein Musik Festival në Gjermani, Bregenz Festspiel në Austri, Festivali I muzikës së dhomës në Grosseto, Itali, në Festivalin Remusika si dhe në Kamermusik Festival në Kosovë, etj. Është interpretuesja e shumë premierave të veprave për piano të kompozitorëve shqiptarë si dhe të disa premierave shqiptare, si integralia e veprave për piano të Xenakis në Festivalin Vjeshta e Tiranës 1998, ku në sallë ishte I pranishëm vetë autori. Në vitin 2009 ka regjistruar një cd me vepra të Schumann-it.

Në Shqipëri është fituese e disa çmimeve si Interpretuesja më e mirë në Festivalin e muzikës së re shqiptare në 1996, dhënë nga një juri e kryesuar nga kompozitori francez G. Boeuf, fituese e çmimit Kult si Interpretuesja më e mirë e vitit 2010.

Punon në Universitetin e Arteve në Tiranë si pedagoge në Katedrën e Pianos. Ka titullin Profesor I Asociuar që prej vitit 2007.



16:00 • Salla e Kuge / Red Hall

# PASDITE KORALE / CHORAL AFTERNOON

Shkolla e Muzikës "Halit Kasapolli" Pejë

Memli Kelmendi, dirigjent / conductor

**Lorenc Antoni** 

Mirëmbrama

Memli Kelmendi

Vemi o vemi

Milito Vako

Janinë, Janino

**John Bennet** 

Weep, O mine eyes

**Criss Lawry** 

**Counting Music** 

"Ladie's Voice" Gjilan

Florentina Rushiti Bajrami, dirigjente / conductor

**Astor Piazzolla** 

Liber Tango

arr/ Mac Huff

Stand by Me

**Linda Spevacek Avery** 

Danza

Shkolla e Muzikës "Prenk Jakova" Prishtinë

Rahmi Ymeri, dirigjent / conductor

Çesk Zadeja

Rritu moj bajame

Anon.

La Violetta



•••••

Anon.

Joshua fight the Battle of Jericho

arr / Rahmi Ymeri

Po na vjen karrai në dru

Shkolla e muzikës "Tefta Tashko" Mitrovicë

Lirije Halili Koshi, dirigjente / conductor

**Shime Deshpali** 

Dashnor t'u bana

Johannes Brahms

Am Gesteine rauscht die Flut Nein es ist nicht auszukommen Kori i fëmijëve te qytetit Gjakovë

Astrit Pallaska, dirigjent / conductor

R. Kelly

I Believe I Can Fly From Space Jam

**Leonard Cohen** 

Hallelujah From Shrek

Kori qytetit - Ferizaj

Lindita Isufi, dirigjente / conductor

••••••

**Rauf Dhomi** 

Të falemi o dhe

Çesk Zadeja

Sjkon djali termal







••••••

është një nga ansamblet kryesore të perkusioneve në botë. Dinamizmi i pashoq dhe energjia në performancat e Kroumatës kanë mahnitur publikë në mbar botën botën. Përvoja unike e përjetuar në koncertet e Kroumatës, pëlqehet nga publiku i moshave dhe prejardhjeve kulturore të ndryshme

Kroumata ka pasur turne në rreth 40 vende dhe kanë performuar recitale nëpër gjithë botën, me Filharmoninë e Berlinit, Teatro Solis dhe Wineret Konzerthaus, si dhe turne në Argjentinë, SHBA, Australi, Belgjikë, Qipro, Lituani eti.

Përveç recitaleve, Kroumata kërkohet të performoj si ansambël solistik me orkestra apo ansamble tjera. Grupi ka patur paraqitje me Filharmoninë e Los Angeles, Berliner Symphoniker, Orkestren Simfonike Kombëtare të Lituanisë etj. Gjithashtu, performuan në festivale të shumta, duke përfshirë Huddersfield Contemporary Music Festival, TUMPAC Montevideo, Vilnius Festival, Belgium Percussion Festival, Cyprus Pharos Trust, Inventionen Berlin eti.

Në Suedi, Kroumata ka publikë besnike dhe vendet në koncertet e tyre janë gjithmonë të plota, në mbarë vendin. Pëlqehet nga të gjithë, pulbikë e moshave dhe prapavijave të ndryshme. Ndër tjerash, Mbreti Carl XVI Gustaf i Suedisë është mbështetës besnik i Kroumatës. Anëtarët e Kroumatës janë: Johan Silvmark, Ulrik Nilsson, Pontus Langendorf, Roger Bergström.







# 25 Maj / May E Diel / Sunday

20:00 · Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony"

# RECITAL KITARË/GUITAR

Petrit ÇEKU kitarë/guitar

#### Johann Sebastian Bach

(arr: Valter Dešpalj)

Suita e tretë për violonçel solo / Cello Suite III BWV 1009 Prélude / Allemande / Courante / Sarabande / Bourrée I, II / Gigue

# **Dionisio Aguado**

Fandango Variado, op.16

### **William Walton**

Five bagatelles
Allegro / Lento, tempo di valse / Alla cubana / Sempre espressivo / Presto con slancio

# Joaquín Rodrigo

En Los Trigales Tres piezas españolas Fandango / Passacaglia / Zapateado



## **Petrit ÇEKU**

. . . . . . . . . . . . .

lindi në Prizren ku filloi edukimin muzikor në klasën e Luan Sapunxhiut. Në vitin 2002 u bart në Zagreb për të vijuar shkollimin me Xhevdet Sahatçiun dhe më pas me Darko Petrinjakun në Akademinë e Muzikës në Zagreb, ku diplomoi në vitin 2008. Ai vazhdoi studimet postdiplomike me kitaristin e njohur Manuel Barrueco pranë konzervatorit Peabody ne Baltimorë, SHBA. Çeku është fitues i 9 çmimeve të para në konkurse ndërkombëtare kitaristike, së fundi në konkursin Christopher Parkening në Malibu të Kalifornisë, SHBA (2012), Schadt në Allentown, SHBA (2011) dhe Maurizio Biasini në Bologna, Itali (2011). Ai është gjithashtu edhe fitues i konkursit prestigjioz Michele Pittaluga në Alessandria, Itali (2007).

Petrit Çeku ka koncertuar në shumë vende të Evropës dhe Amerikës Veriore me recitale solistike, si dhe në bashkëpunim me orkestrat simfonike si Allentown Symphony, Baltimore Symphony, Orkestra Kamertale e Filharmonisë Çeke, Orkestra Simfonike e RTSH-së, Orkestra Shtetërore e Hermitazhit të St. Petersburgut, Filharmonia e Kosoves dhe Filharmonia e Zagrebit. Ai gjithashtu ka bashkepunime të vazhdueshme me orkestrën harkore Solistët e Zagrebit dhe është themelues i trios kitaristike Elogio.

Në vitin 2008 Çeku lansoi kompakt diskun e parë me etiketën e kompanisë amerikane diskografike Naxos. Po atë vit u shpërblye me çmimin vjetor të Filharmonisë së Zagrebit – Muzikanti më i mire i ri i vitit. Petrit Çeku luan në kitarë të ndërtuar nga Ross Gutmeier.

# **26** Maj / May E Hënë / Monday

20:00 • Kisha Katolike "Shën Ndou" / Catholic Church "St. Anthony"

# NATA MINIMALISTE / MINIMALIST NIGHT

The Cone Gatherers

Branka PARLIC piano

#### **Erik Satie**

Cold Pieces Air that chase away No. 2 Crossed-up Dance No. 2

### Jeroen van Veen

Minimal Prelude No. 18

## **Graham Fitkin**

The Cone Gatherers

# **Howard Skempton**

Piano Works
Saltaire melody
Sweet Chariot
Well, well, Cornelius
(1982, dedicated to Cornelius Cardew, 1936-1981)

## **Alvin Curran**

For Cornelius

## **Philip Glass**

Mad Rush



#### **Branka PARLIC**

Pianistja Branka Parlić është një nga interpretuesit më prominent të muzikës kontemporane të ish regjionit të Jugosllavisë. Ajo diplomoi në Fakultetin e Arteve Muzikore, të Univerzitetit te Arteve në Beograd, në fund të viteve 1970-a, nën udhëheqjen e professor Olga Mihailović. Më vonë mprehu shkathtësinë e saj në Akademinë Verore të Muzikës në Nicë, nën drejtimin e profesorit Pierre Sancan nga Konservatori i Parisit. Që nga 1986, përkushtoi punën e saj si koncert pianiste dhe ligjeruese e muzikës së kompozitorit françez Erik Satike, si dhe të Muzikës së Re të Shekullit XX dhe XXI – Minimalizmit dhe Post Minimalizmit. Botoi në vinil

Initiés (1988) dhe CD-në Initiés '88 - Initiés '99, me muzikë të kompozitorit françez Erik Satie dhe CD-në Metamorphosis (2004) me pjesët për piano të Philip Glass. CD-të dhe koncert videot e saj rregullisht shfaqen në Radiot dhe Televizionet me nam të Rajonit, si dhe në


British C Music TV.

Botimi vinil Satie & Beyond është publikuar në Janar 2014, nga Sing-Sing Studios në Holandë, ku prezantohen pjesët për piano të Erik Satie, Graham Fitkin, Jeroen van Veen dhe Philip Glass. Branka Parlić performoi si soliste dhe muzikante kamertale në Sërbi, Mal të Zi, Slloveni, Gjermani, Francë, Angli, Austri, Maqedoni, Kroaci, Hungari, Zvicërr dhe Holandë.

Ajo vepron si profesor i pianos në Akademinë e Arteve, të Univerzitetit të Novi Sadit.

Që nga 2006, është Drejtor Artistik i serialeve koncertale New Ears for New Music në Novi Sad, kushtuar Muzikës së Re.





#### Rafael MUNOZ-GOMEZ

lindi në Bruksel në vitin 1988. Pasioni për muzikën, sidomos për Lëvizjen Minimaliste të Teknos, e shtyen në Konservatorin Mbretëror të Monsit në Belgjikë, në klasën e Kompozimit Akusmatik të Annette Vande Gorne. Rafaeli është i tërhjekur nga muzika repetitive, ritmi, tiparet e tingullit dhe studimi i secilës imtësi të tij. Sot, ai mundohet që puna e tij të bazohet në kombinim të të gjitha këtyre elementeve. Ishte piese e performançave direkte eksperimentale në fes-Sonic», «Festival Résonances», «Museum Night Fever» në Teatrin Mbretëror të la Monnaie në Bruksel dhe "MyMudam days" në MUDAM, Museun e Artit Modern në Luksemburg. Në prill 2014, fitoi çmimin per muzikën më të mirë filmike në Edicionin e 30 të "Festival du Cinéma Européen në Lilë", për filmin e metrazhit të shkurtë "Welkom" të Pabo Munoz

Rafael është poashtu përgjegjës i Akosmoniumimit (Orkestres së autoparlantëve) në "Musiques & Recherches" të Belgjikës, që nga janari 2014.

#### **Donika RUDI**

